STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 15 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIMBURSIMIN FEDERAL PER QYTEZEN STONI POINT (STONY POINT) PER KOSTOT E SUPER STUHISE SENDI (SANDY)

Guvernatori drejton mbi 100,000 dollarë në fonde të miratuara nga FEMA tek Stoni Point (Stony Point) për kostot e pastrimit pas super stuhisë Sendi (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka siguruar 140,333 dollarë për Qytezën e Stoni Point (Stony Point) në Qarkun Roklënd (Rockland County) për rimbursimin e kostove të pësuara nga Qyteza pas pasojave të super stuhisë Sendi (Sandy). Fshati i Stoni Point (Stony Point) pastroi rrugët për automjetet e emergjencave, krijoi barrikada dhe vendosi shenja sipas nevojës për publikun për shkak të mungesave të energjisë. Qyteza gjithashtu përdori qese me rërë për të moslejuar përmbytjen e ndërtesave. Reagimi përfshiu policinë, personelin e EOC-së, Departamentet e Autostradave, Parqeve dhe Ujrave të Zeza.

“Eshtë vendimtare që t’i dërgojmë këto fonde të rimbursimit federal tek vendet si Qyteza e Stoni Point (Stony Point) që iu përgjigjën sfidës e pasojave të Sendit (Sandy),” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Administrata ime është duke punuar pa lodhje që këto fonde të Ndihmës Publike të FEMA-s të drejtohen përsëri drejtpërdrejt tek komunitetet që gërmuan thellë në buxhetet e tyre për të reaguar sa më mirë që mundën ndaj stuhisë. Jam shumë i gëzuar të jem në gjendje që të drejtoj këto fonde përseri tek qyteza dhe t’i ndihmoj ata të vazhdojnë në përpjekjet e tyre të përgjithshme për rimëkëmbje.”

Senatori Bill Larkin, "Përgëzoj Guvernatorin për bërjen e këtij rimbursimi federal një përparësi për Qytezën e Stoni Point (Stony Point). Përpjekjet e reagimit pas super stuhisë Sendi (Sandy) ishin të pashembullta dhe ky fond do të lejojë që qyteza të rimëkëmbet financiarisht duke ditur se Shteti i Nju Jorkut (New York State) nuk ka harruar përpjekjet e jashtëzakonshme të tyre në emër të banorëve të tyre dhe punonjësve të emergjencës që punuan pa lodhje gjatë dhe pas stuhisë."

Anëtari i asamblesë Xhejms Skufis (James Skoufis) tha, “Super stuhia Sendi (Sandy) jo vetëm që la shkatërrim pas në Ba Mar dhe në River Road e Grassy Point Road, por ishte gjithashtu një përpjekje e kushtueshme e rimëkëmbjes. Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për drejtimin e këtij fondi mjaft të nevojshëm tek Stoni Point (Stony Point). Banorët dhe bizneset vendase vepruan në këtë rast pasi goditi Sendi (Sandy), por kostoja e pastrimit vendosi presion financiar shtesë mbi qytezën. Ky fond do të jetë i rëndësishëm për ndihmën që komuniteti të vazhdojë të rindërtohet.”

“Rikthimi i komuniteteve të dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy) është përparësia më e lartë e departamentit tonë dhe këto fonde të rimbursimit të Ndihmës Publike do të ndihmojnë secilin nga komunitetet e prekura që të rivendosin në rregull punët fiskale të tyre,” tha Komisioneri i Seksionit të Sigurisë së Atdheut dhe Shërbimeve të Urgjencës të NYS-së (NYS Division of Homeland Security and Emergency Services Commisioner) Xherom M. Hauër (Jerome M. Hauer).

Dhënia e këtyre fondeve federale është pjesë e rimbursimeve në vazhdim dhe në pritje në të ardhmen që shteti do të administrojë dhe paguajë tek komunat e prekura. Komunat janë duke u rimbursuar mbështetur në një shumëllojshmëri projektesh që përfshijnë ndërtimin dhe shkatërrimin, heqjen e mbeturinave ranore dhe bimore, aktivizime të EOC-së, largime, kontrolle dhe riparime dhe rivendosje emergjente të teknologjisë së informacionit dhe programin Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (Sheltering and Temporary Essential Power) (STEP). Shteti do të vazhdojë t’i bëjë këto pagesa të rimbursimeve ndërsa FEMA jep fondet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418